



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor, 2008), të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 01.10.2021, merr këtë

V E N D I M
PËR NDARJEN E MJETEVE PËR ORGANIZIMIN E KAMPIONATIT BOTËROR
UNIVERSITAR TË HENDBOLLIT

I.

MIRATOHET Vendimi për ndarjen e mjeteve për organizimin e Kampionatit botëror universitar të hendbollit.

II.

Shuma e mjeteve të ndara, sipas pikës I të këtij vendimi, është 75.000 €, shumë kjo e siguruar nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve, programi i Administratës së përgjithshme, ---, mjetë nga të hyrat vetanake.

III.

Qëllimi i këtij vendimi është dhënia e ndihmës, të cilën Komuna e Prishtinës e ndan për organizimin e Kampionatit botëror universitar të hendbollit.

IV.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave.

V.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-400/03-209748/21, më 04.10.2021

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

Adresa: Rr. UÇK - 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
<http://www.prishtina-komuna.org>

